



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 183 Prot.

Tiranë, më 22.12.2022

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 7 datë 22.12 2022

“Për miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”

Në mbështetje të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, e ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

VOLTISA BLETA

Anëtarë

Znj. Anila Feriza

Znj. Enkeleda Riza

Z. Stefan Çapaliku

Znj. Brunilda Spahiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 183/1 Prot.

Tiranë, më 22.12. 2022

PROCESVERBAI

**I MBLEDHJES SË KËSHILLIT KOORDINUES TË BOTIMEVE PËR DIASPORËN**  
(i zbardhur)

I mbajtur më 22 dhjetor 2022, në mbledhjen e radhës së **Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën**, i cili u zhvillua në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Tiranë.

**Marrin pjesë:**

1. Znj. Voltisa Bleta, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
2. Znj. Anila Ferizaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
3. Znj. Brunilda Spahiu, përfaqësuese e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë;
4. Znj. Enkeleda Riza, përfaqësuese e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Marrin pjesë, si përfaqësues të Qendrës së Botimeve për Diasporën:**

1. Znj. Mimoza Hysa, drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën;
2. Znj. Eva Ismajlukaj, përgjegjëse e Sektorit të Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve;
3. Fabjola Caushaj, përgjegjëse e Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën;
2. Çështje të tjera.

Faqe 1 nga 6

Adresa: Rruga "Vilat Gjermane", Vila Nr.6, Tiranë, Shqipëri  
info@qbd.gov.al

## HAPET MBLEDHJA

Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, **znj. Mimoza Hysa**, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Znj. Mimoza Hysa**, lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Miratimi i raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën;
2. Çështje të tjera.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

## PIKA E PARË E RENDIT TË DITËS

Mbledhjen e hapi **znj. Mimoza Hysa**, e cila bëri një paraqitje të punës së bërë nga Qendra e Botimeve për Diasporën gjatë vitit 2022, botimet, projektet, aktivitetet e realizuara dhe arritjet e Qendrës së Botimeve për Diasporën.

- ❖ **Në pjesën e parë, znj. Hysa**, u ndal në sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore dhe literaturë plotësuese.

Ky ishte viti i parë që Qendra e Botimeve për Diasporën siguroi dhe në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme shpërndau tekstin e përbashkët “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare*”, niveli I. Këtë vit QBD-ja përveç tekstit fizik i dërgoi shkollave në diasporë edhe tekstin digjital, shprehet ajo.

Referuar pikës nr. 6 dhe 7 të VKM-së nr. 443, datë 26.06.2019, “*Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë*”, Urdhrit të Përbashkët nr. 4801 Prot., datë 8.9.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë, nr. 4184 Prot., datë 7.09.2021, të Ministrit të Shtetit për Diasporën, si dhe nr. 01B/294 Prot., datë 29.09.2021, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “*Për miratimin e tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I*, Vendimit nr. 2, datë 28.07.2022, të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën “*Për miratimin e listës së teksteve shkollorë për mësimin plotësues në diasporë për vitin shkollor 2022-2023*”, si dhe referuar kërkesave të ardhura me shkresë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën, me nr. 9030 Prot., datë 4.07.2022, “*Kërkesat për tekstet shqip për vitin shkollor 2022-2023*”, protokolluar me tonën me nr. 68 Prot, janë siguruar 6411 tekste

Faqe 2 nga 6

Adresa: Rruga “Vilat Gjermane”, Vila Nr.6, Tiranë, Shqipëri  
info@qbd.gov.al

shkollore për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë (5134 libra fizikë + 1277 libra digjitalë).

Sipas shteteve kemi realizuar këtë shpërndarje tekstesh në 18 shtete: Itali 1042 tekste, Greqi 1342 tekste, Gjermani 645 tekste, Zvicër 900 tekste, Belgjikë 150 tekste, Turqi 75 tekste, Hungari 20 tekste, Australi 20 tekste, Slloveni 15 tekste, Madrid 30 tekste, Kanada 405 tekste, Republika Çeke 20 tekste, Rumani 10 tekste, Suedi 602 tekste, Mbretëri e Bashkuar 715 tekste, Kroaci 50 tekste, Danimarkë 120 tekste, SHBA 250 tekste.

**Kryetarja e Këshillit, znj. Voltisa Blea**, merr fjalën dhe pyet nëse ka pasur ankesa apo shqetësime në lidhje me shpërndarjen e teksteve?

**Znj. Mimoza Hysa**, merr fjalën dhe përgjigjet se QBD-ja ka raportuar vazhdimisht dhe ka dërguar informacione në lidhje me problematikat e shpërndarjes. Teksti digjital i dërguar këtë vit ka qenë një problematikë më vete, e cila do na ndihmojë edhe ne të kemi një pasqyrë më të qartë për shpërndarjen vitin e ardhshëm.

❖ **Në pjesën e dytë, znj. Hysa**, u ndal në realizimin e programit të botimeve.

QBD-ja ka përmbyllur botimet e dy teksteve të Mitrush Kutelit në gjermnaisht dhe në anglisht që nuk kanë qenë botuar, është botuar numri i dytë i revistë sletrare “*Letar nga Diaspora*” në anglisht, është botuar katalogi i përditësuar botimeve të Qendrës së Botimeve pr Diasporën, shprehet znj. Hysa.

❖ **Në pjesën e tretë, znj. Hysa**, u ndal te aktivitetet ku ka marr[ pjes QBD-ja dhe aktivitetet e prganizuara prej saj.

Në bazë të VKM-së nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, i ndryshuar me VKM-në nr. 1033, datë 16.12.2020, “*Për disa shtesa në vendimin nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave*”, Qendra e Botimeve për Diasporën ka detyrim për organizimin e takimit mbarëkombëtar të mësuesve dhe takimit mbarëkombëtar të shkrimtarëve, të cilin kësaj e herë e organizuam në dy ditë të njëpasnjëshme. Edhe për këtë aktivitet janë realizuar botime infomuese të nevojshme për aktivitetin, shprehet znj. Hysa në fjalën e saj.

❖ **Në pjesën e katërt, znj. Hysa**, u ndal në punën e realizuar nga Sektori i Digjitimit, Komunikimit dhe Projekteve.

Ky sektor ka vijuar ka vijuar punën me projektin e miratuar në vitin 2019, i cili është parashikuar edhe në Strategjinë e Diasporën 201-2024 dhe ne Strategjine e re 2021-2025, që është projekti i Platformës Digjitale. Ky është një projekt që ka mbetur pa u realizuar

---

Faqe 3 nga 6

Adresa: Rruga “Vilat Gjermane”, Vila Nr.6, Tiranë, Shqipëri  
info@qbd.gov.al

për shkak të buxhetit të madh që kërkon. Për këtë projekt ne kemi vijuar vetëm me anës përmbajtësore, pra të mësimet që do të përmbajë platforma. Përsa i përket anës teknike kemi kërkuar nëse do ishte e mundur realizimi i punës me mbështetjen e dy vendeve, të Shqipërisë dhe të Kosovës, por kjo është një procedurë akoma në proces dhe akoma nuk kemi një vendim përfundimtar për realizimin e saj, shprehet drejtoresha e QBD-së.

❖ **Në pikën e pestë, znj. Hysa,** u ndal te përgatitja e videove për mësimin e gjuhës shqipe.

Kemi realizuar deri tani 30 video, të cilat do të publikohen në periudhën janar-mars 2023. Këto video do t'u vijjnë në ndihmë mësuesve, nxënësve në diasporë, por edhe nxënësve të huaj që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe, duke qenë se edhe interesi për mësimin e gjuhës shqipe është në rritje. Këto materiale në format video do të publikohen nga Qendra e Botimeve për Diasporën në kanalën e saj në YouTube dhe në rrjetet e saj sociale, duke synuar që të përbëjnë bazën e platformës “Mëso shqip” dhe do të ndihmojnë në procesin e mësimin të gjuhës shqipe në diasporë, shprehet ajo.

❖ **Në pikën e gjashtë, znj. Hysa,** u ndal në bashkëpunimet me institucionet brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, si dhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për rishikimin dhe miratimin e “Standardeve për Tekstet Mësimore të Mësimin Plotësues të Gjuhës Shqipe në Diasporë dhe Mërgatë”, në përputhje me legjislacionet e të dyja vendeve.

Me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka vijuar bashkëpunimi për hartimin e Regjistrin Kombëtar të Mësuesve në Diasporë, për përcaktimin e nevojave për tekste dhe materiale plotësuese për mësimdhënien në diasporë, për zgjerimin e hartës së shkollave, për sigurimin dhe konfirmimin e numrit të mësuesve dhe nxënësve të gjuhës shqipe në diasporë.

Është ndërtuar gjithashtu një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vendosjen e kontakteve me shkollat shqipe, shoqatat kulturore dhe mësuesit në diasporë për sigurimin e kërkesave për tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I, dhe literaturës plotësuese për vitin shkollor 2022–2023.

❖ **Në pikën e shtatë, znj. Hysa,** u ndal në aktivitetet ku QBD-ja ka marrë pjesë.

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në seminarin njëditor të mësimin plotësues të gjuhës shqipe me tematikë “Informimi i ndërsjellë, shkëmbimi i përvojave në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies”, i cili u organizua nga shoqata shqiptare “Progresi-

---

faqe 4 nga 6

Adresa: Rruga “Vilal Gjermane”, Vila Nr.6, Tiranë, Shqipëri  
info@qbd.gov.al

Proodos” në Selanik të Greqisë dhe Lidhjes së Shoqatave Shqiptare “Iliria” në Malmo të Suedisë.

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në Panairin e Librit 2022, nëpërmjet bashkëpunimit me “*Albania Letteraria*” të portalit “Albania News”, me një standë të veçantë ku u paraqitën botimet e QBD-së.

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD), në vazhden e takimeve të përvitshme me mësuesit dhe shkrimtarët në diasporë, si dhe në kuadër të 110-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë dhe të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimnit, organizoi aktivitetin dyditor me titull “*Shqipja në diasporë*”, në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe me praninë e institucioneve kryesore kërkimore shkencore dhe universitare në Shqipëri, Kosovë e diasporë, të institucioneve të mësimdhënies së gjuhës shqipe në botë, si dhe të autorëve, shkrimtarëve e përkthyesve brenda dhe jashtë vendit. Aktiviteti u zhvillua në datat 26 nëntor 2022 në Tiranë dhe 27 nëntor 2022 në Shkodër, me prani fizike dhe virtuale.

Më 8 tetor 2022 u zhvillua në Tiranë trajnimi online për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, i përgatitur dhe i mbajtur nga Qendra e Trajnimeve të Shtëpisë Botuese “Albas” për paketën didaktike “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I, të hartuar nga Shtëpia Botuese “Albas” dhe Shtëpia Botuese “Dukagjini”, për modulën “Mësimdhënia e gjuhës shqipe për mësuesit e diasporës”. Trajnimi i mbajtur në formatin online në platformën “Zoom” u zhvillua me qëllim që mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë të njihen me përmbajtjen shkencore dhe aspektin didaktik e pedagogjik të mësimdhënies së librit “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli I.

Më 17 dhjetor 2022, Qendra e Botimeve për Diasporën organizoi në Milano të Italisë trajnimin njëditor për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë “Metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësit”, i organizuar nga shkolla shqipe “Dora e Pajtitit” në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën, e pranishme gjithashtu në trajnim.

Më 18 dhjetor 2022, Qendra e Botimeve për Diasporën, organizoi në bashkëpunim me Këshillim Koordinues të Arsimit në Diasporë trajnimin njëditor për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë me temë “Metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësit”.

**Kryetarja e Këshillit, znj. Voltisa Bleta**, ndërhyu dhe pyet për realizimin e anës financiare

- ❖ **Pika e fundit ku u ndal znj. Hysa** në prezantimin e raportit ishte buxheti. Ajo theksoi se pjesa e vetme e buxhetit që nuk është mbyllur është ajo e investimeve.

**Znj. Enkeleda Riza**, pas paraqitjes së raportit kërkon fjalën dhe është dakord për miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

**Znj. Brunilda Spahiu**, pas paraqitjes së raportit kërkon fjalën dhe është dakord për miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

**Znj. Anila Ferizaj**, pas paraqitjes së raportit kërkon fjalën dhe është dakord për miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Në fund të këtyre diskutimeve e rimerr fjalën **Kryetarja**, e cili parashtron se është dakord me projektin e paraqitur, dhe miratohet, pa riformulime, miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.

*Anëtarët e Këshillit votuan unanimitisht për miratimin e raportit vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën.*

Kryetarja e Këshillit, **znj. Voltisa Bleta**, deklaron mbylljen e mbledhjes dhe ngarkon Qendrën e Botimeve për Diasporën për zbatimin e vendimit të marrë.

Procesverbali përbëhet nga 6 (gjashtë) fletë dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të pranishmit.

### **Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën**

**VOLTISA BLETA (KOÇI)**

**Anëtarë:**

**Znj. Anila Ferizaj** \_\_\_\_\_

**Znj. Enkeleda Riza**

**Z. Stefan Çapaliku** \_\_\_\_\_

**Znj. Brunilda Spahiu** \_\_\_\_\_